

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E INSIG SHA MAQEDONI**

Raporti Përfundimtar i auditimit të ushtruar në INSIG SHA Maqedoni me objekt “Mbi zbatimimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2014 deri 31.08.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimet e Kryetarit të KLSH nr. 174, datë 29.12.2015 dhe nr. 4, datë 08.01.2016.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresë nr. 804/10, datë 29.12.2015, dërguar z. Asllan dashi në INSIG SHA Maqedoni, me shkresë nr. 804/11, datë 29.12.2015, dërguar Këshillit Mbikëqyrës, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Nga auditimi u konstatuan një sërë shkeljesh ndër të cila më kryesore janë:

1. Në vitin 2009, INSIG SHA ka ndryshuar pronësinë e aksioneve duke i riblerë ato në masën 100 %. Ky ndryshim nuk është shoqëruar me zvogëlimin e numrit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës në 3, por në vend të anëtarëve të emëruar nga IFC dhe BERZH (zotërues të një pjese të aksioneve para vitit 2009), janë emëruar 2 anëtarë nga Ministria e Financave, duke e lënë numrin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës me 5 anëtarë. Në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar, përcaktohet se, për shoqëritë anonime (aksionare) shtetërore jo strategjike, numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës duhet të jetë 3.

2. Nga auditimi me zgjedhje për marrjen në sigurim të jetës, jo-jetës dhe vlerësimi i pagesave të dëmeve me vlera të mëdha konstatohet se, rastet që janë trajtuar me procese gjyqësore, kanë patur një ndikim të madh në vlerën e pagesës së dëmeve. Nga ana e Shoqërisë nuk është analizuar ky fenomen për vlerësimin e riskut apo dhe përcaktimin e përgjegjësisë, si nga ana e rritjes së përfaqësimit dhe profesionalitetit në mbrojtjen e çështjeve, ashtu dhe në rritjen e negocimit me palët e dëmtuara, për parandalimin e mundshme të ankimimit organet kompetente ligjore.

-Kryesisht dosjet e verifikuara të cilat kanë Karton Jeshil, janë paguar në bazë të debit note (faturës), të dërguar nga shteti në të cilin ka ndodhur aksidenti, sipas dokumenteve të vëna në dispozicion.

-Pothuajse të gjitha rastet e paditura në organet gjyqësore rezultojnë të humbura nga Shoqëria, veprime të cilat tregojnë cilësi të dobët të mbrojtjes së çështjeve. Po ashtu, nuk ka analiza të realizuara për zbutjen e fenomenit dhe mundësimin e parandalimit të këtyre çështjeve nëpërmjet negocimit me palët e dëmtuara.

-Pagesat e dëmeve jo materiale zënë rreth 50 % të dëmeve në total. Duke marrë në konsideratë se shumë aksidente shoqërohen me dëme materiale dhe jo materiale njëkohësisht, për një numër të caktuar aksidentesh vlera e dëmeve jomateriale të likuiduara theksohet. Nga ana e Shoqërisë duhet të analizohej shpenzimi sipas këtij zëri, sidomos për faktin se kemi të bëjmë me një fushë specifike, duke rritur kontrollin dhe monitorimin për minimizimin e vlerës së dëmeve që likuidohen.

-Vlerësimi kryesisht i dëmeve materiale, është shoqëruar me mangësi dhe pasaktësi duke likuiduar padrejtësisht palët e dëmtuara. Ka mangësi në vërtetimin e rrethanave dhe në vlerësimin e dëmeve, kryesisht në dëme të cilat sigurohen nëpërmjet TPL.

-Në disa raste dëmet e likuiduara (kryesisht materiale), rezultojnë edhe mbi vlerën e llogaritur për shlyerjen e vlerës së plotë të automjetit. Referencat për çmimet e riparimit të automjeteve të dëmtuara merren vetëm nga një burim dhe paraqitet nga vetë pala e dëmtuar, duke krijuar mundësi për shmangie nga çmimet reale dhe rrjedhimisht rritje fiktive të fondeve që paguhen për likuidimin e dëmeve materiale.

-Parregullsitë në të shumtën e rasteve rezultojnë për raste kur poseduesit e mjeteve të përfshira në aksidente bien dakord ndërmjet tyre dhe nuk paraqitet i nevojshëm procesverbali i organeve të rendit. Për këtë rast duhet të theksojmë se, pavarësisht se kemi të bëjmë me raste me vlera

relativisht të vogla (nën 30,000 MKD, ose 489.4 Euro), në total për periudhën 01.01.2014 deri 31.06.2015, ato përfaqësojnë 1145 raste me vlerë totale 14,383,608 MKD, ose 11.5 % të dëmit total të likuiduar, pra pavarësisht se në dukje duken vlera të vogla, nga ana e Shoqërisë nuk ka funksionuar siç duhet sistemi i kontrollit të brendshëm për këto raste.

-Pagesat e dëmeve sipas primeve të kartonit jeshil bëhen sipas faturave që paraqiten nga shoqëritë apo byrotë e sigurimeve të shteteve ku ndodhin aksidentet, pas asnjë reklamim. Në rastet e dosjeve të audituara nga grupi i auditimit konstatohen dëme të papërfillshme të likuiduara me vlera të konsiderueshme. Për këto raste, INSIG SHA Maqedoni duhet të kërkonte që çështjet të trajtoheshin në arbitrazh.

3. Nga auditimin me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe shpenzime administrative rezultoi se, nuk janë analizuar përgjegjësitë, dhe nuk është bërë analizë mbi shkaqet likuiditeteve për ekzekutimet e urdhrave të përmbarimit, në kundërshtim me MFK nr. 0203-03, datë 21.02.2014, pika 5.2.12 “Shpenzime për gjoba, penalitete e kamatëvonesa”, ku për periudhën e auditimit është likuiduar vlera prej 28,392 Euro, e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë.

4. Nga auditimi i mbajtjes së evidencave kontabile rezultoi se, Shoqëria në hartimin e pasqyrave financiare ka vepruar në kundërshtim me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 10 për “Korrigjimin i ngjarjeve pas datës së bilancit”, paragrafi nr. 8. Gabimi në hartimin e pasqyrave financiare është material sepse mosbatimi i tij ka shtrembëruar rezultatin e shoqërisë. Mosparaqitja e drejtë dhe e saktë e rezultatit financiar ka rezultuar dhe me efekt financiar negativ me vlerë 542.774 MKD ose 8.826 Euro, pasi shoqëria ka paguar tatimin për fitimin e vitit 2014.

5. Gjatë auditimit të zbatimit të dispozitave ligjore për administrimin e aktiveve financiare (depozita, bono thesari etj), rezultoi se Shoqëria ka mbajtur depozita në Euro për vitin 2015 shumën 1,384,000 MKD. Interesat e depozitave në banka në MKD për vitin 2015 kanë qenë 1.41 % më të larta se interesat e depozitave në Euro. Me këto veprime ose mosveprime i është krijuar shoqërisë një e ardhur e munguar me vlerë 7,300 Euro. Po ashtu në vitin 2014 shoqëria ka investuar shumën 12,310,000 MKD me periudhë 1-vjeçare dhe me interes 2.35 % si dhe shumën 18,450,000 MKD me periudhë 1-vjeçare dhe me interes 3.9 %, duke krijuar një e ardhur e munguar me vlerë 190,800 MKD ose 3,100 Euro.

6. Nga auditimi i disa dosjeve të vlerësimit të dëmeve janë konstatuar mangësi në kundërshtim me Manualin e Vlerësimit të dëmeve. Dëmi i konstatuar është në vlerën 3,408 Euro, vlerë e cila është rekomanduar për zhdëmtim sipas personave përgjegjës.

7. Nga auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, shpenzimet e marketingut, shpenzimet e marrjes në sigurim, komisione e bonuse, penalitete, gjoba etj.), janë konstatuar parregullsi të shoqëruara me dëm ekonomik me vlerë 12,954 Euro, vlerë e cila është rekomanduar për zhdëmtim, sipas personave përgjegjës.

8. Në lidhje me zbatimin e kontratës “Blerje reklama” me nr. 102/14, datë 22.09.2014, të lidhur me vlerë 2,552,340 MKD, për periudhën e reklamimit për 4 muaj, likuidimi i plotë i vlerës është bërë 2 muaj para përfundimit të kontratës. PAGESA e mësipërme është kryer duke mos patur bashkangjitur gjithë dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shërbimi, në kundërshtim me rregulloren e MFK nr. 0203-3, datë 21.02.2014, pika 7.3 “Pagesat për reklama”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë sektorit publik”, pika 35, germa b dhe pika 36, me pasojë dëm ekonomik për shoqërinë në shumën 1,276,170 MKD/61.5 ose 20,750 Euro.

Në përfundim të auditimit, KLSH ka dhënë një sërë rekomandimesh për përmirësimin e situatës, ndër të cilat më kryesore janë:

1. MZHETS, në cilësinë e Aksionarit, të marrë masa për ndryshimet në Nenin 50 të Statutit të Shoqërisë, për reduktimin e numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar.

2. INSIG SHA Maqedoni të analizojë dhe vlerësojë riskun e lartë që kanë rastet që parashtrihen në organet gjyqësore. Në përputhje me manualin e vlerësimit të dëmeve, të rriten përpjekjet për shmangien e trajtimit të këtyre çështjeve në organet gjyqësore. Të analizohen të gjitha rastet që janë fituar në organet gjyqësore, duke nxjerrë përgjegjësitë në vendimin e komisionit apo mos mbrojtje nga stafi i Shoqërisë në gjyq.

-Të merren masa dhe të njoftohen organet kompetente në lidhje me pagesat e dëmeve sipas kartonit jeshil, si dhe për raste të arsyeshme, të bëhen njoftimet për kalimin e çështjeve në arbitrazh.

-Të analizohet dhe rritet kontrolli mbi identifikimin dhe vlerësimin e pagesat e dëmeve kryesisht ato jo materiale, duke bërë edhe ndryshimet e duhura në rregulloren e Shoqërisë.

3. INSIG SHA të analizojë rastet e sipërcituara duke përcaktuar një procedurë konkrete të përmbushjes së detyrimeve gjyqësore për sa kohë mos përmbushja sjell kosto shtesë me ndikim për financat e shoqërisë, duke nxjerrë përgjegjësitë dhe shkaqet e këtyre likuiditeteve, për ekzekutimet e urdhrave të përmbartimit mbi marrjen forcërisht të mjeteve monetare dhe të procedohet më tej mbi këto likuidime.

4. Bordi Drejtues të sigurojë zbatimin me korrektësi të standardeve të kontabilitetit dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare të shoqërisë, si një ndër mjetet kryesore për vlerësimin e aktivitetit nga këshilli mbikëqyrës dhe ortakët dhe palët e tjera.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Bordi Drejtues duhet të angazhojnë më shumë strukturat e saj për mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme duke përdorur forma organizative, marrëveshje mes palëve apo me procedura gjyqësore.

5. Shoqëria duhet të hartojë një plan të studiuar të investimeve për optimizimin e të ardhurave të saj, duke menaxhuar në mënyrë korrekte dhe me përgjegjësi likuiditetet. Të realizohen procedurat përkatëse për portofolin e depozitave bankare, për të maksimalizuar fitimet nga këto aktive.

6. KLSH ka rekomanduar zhdëmtimin e vlerave të konsideruara dëm ekonomik në ngarkim të personave përgjegjës.

Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Auditimit të Projekteve dhe Investimeve me Financime të Huaja , Shoqërive Publike , Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Artan Topjana, Erion Muho, Blerin Shkurti dhe Bledi Dervishaj, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj dhe Drejtor i Përgjithshëm Manjola Naço.